

CHALLENGES OF YOUTH MIGRATION IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Drita Memeti

Department Sociology, Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of N. Macedonia,
drita.memeti@unite.edu.mk

Ardita Abduli

Department Sociology, Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of N. Macedonia,
ardita.abduli@unite.edu.mk

Hiriet Ziberi

Department History, Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of N. Macedonia,
hiriet.ziberi@unite.edu.mk

Abstract: in recent years, the phenomenon of migration has gained momentum in the Republic of Northern Macedonia. Although a multiethnic state, migration has affected all ethnicities in the country. According to statistics only in the last 5 years (2013-2018) 30% of young people with higher education have left the country and about 80% of current students plan to leave. In this case of young people leaving, the population in the country is at risk of aging day by day and the consequences of this phenomenon will be evident. The factors of migration in our country are evident, counting here the economic and political reasons, such as: employment difficulties, low wages, party pressures, lack of institutional integration, and even the reasons for a better livelihood, better productivity, the desire for professional improvement etc. Meanwhile, state institutions in the country are working slowly to prevent this phenomenon.

Therefore, this paper aims to present a real picture on the challenges that our country's youth face on their way towards migration to foreign countries.

The paper will focus on the research of the causes and consequences of migration in the country and will focus on the analysis of migration statistical data in the last 5 years identified by EUROSTAT, UNDP, WHO and the State Statistical Office.

Other methods that will be used for this study will be deduction, content analysis, comparison and statistical methods.

Keywords: migration, youth, unemployment, education.

CHALLENGES OF YOUTH MIGRATION IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Drita Memeti

Department Sociology, Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of N. Macedonia,
drita.memeti@unite.edu.mk

Ardita Abduli

Department Sociology, Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of N. Macedonia,
ardita.abduli@unite.edu.mk

Hiriet Ziberi

Department History, Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of N. Macedonia,
hiriet.ziberi@unite.edu.mk

Abstrakt: Dukuria e migracionit vitet e fundit ka marr hov në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Edhe pse një shtet me përbërje multietnike, pavarësisht prej saj migracioni i ka prekur të gjitha etnitë në vend. Sipas të dhënave statistikore vetëm në 5 vitet e fundit (2013-2018) janë larguar nga vendi 30% e të rinjëve me arsim të lartë dhe rreth 80% e studentëve aktualë planifikojnë të largohen. Me këtë rast të largimit të të rinjëve popullsia në vend nga dita në ditë rrezikon të plaket dhe nga ky fenomen pasojat e shoqërisë do të jenë evidente. Faktorët e migracionit në vendin tonë tani më janë të dukshme duke numëruar këtu arsyt ekonomike dhe politike, si: vështirësitë në punësim, pagat e ulëta, presionet partiake, mungesa e integritimit institucional, madje edhe arsyt për një jetesë më të mirë, produktivitet më të lartë, dëshira për përsosje profesionale etj. Ndërkaq institucionet shtetërore në vend po punojnë me hapa të ngadaltë drejt preventivës së kësaj dukurie.

Andaj, ky punim synon të paraqesë një pasqyrë reale mbi sfidat me të cilat përballen të rinjtë e vendit tonë drejt rrugës së migrimit në vendet e jashtme.

Punimi do të përqëndrohet në hulumtimin e shkaqeve dhe pasojave të migracionit në vend si dhe do të fokusohet në analizën e të dhënave statistikore të migracionit në 5 vitet e fundit të evidentuara nga EUROSTAT, UNDP, WHO (World Health Organization) dhe Enti Shtetëror i statistikës.

Kurse nga metodat tjera që do të shfrytëzohen për këtë studim do të jenë: dedukcioni, analiza e përmbajtjes, komparacioni dhe metoda statistikore.

Fjalët kyçe: migracioni, të rinjtë, papunësia, arsimimi.

1.FAKTORËT QË DETERMINOJNË MIGRACIONIN TE TË RINJTË

Kushtet e dobëta të jetesës, problemet mjedisore-ekologjike, mungesa e perspektivave ekonomike, arsimore dhe hendeku në rritje dhe zhvillim midis vendeve të pasura dhe të varfra. Të gjithë këta faktorë janë indikatorë të fuqishëm për largimin e njerëzve nga vendlindja. Gjithashtu në ditët e sotme ndikim të madh në tendencat aktuale të migrimit kanë edhe mediat dhe globalizimi. Thënë konkretisht duke iu qasur rrethanave aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë njerëz që kanë marrë rrugën për tu larguar nga vendi i tyre i lindjes.

Arsyet për migrimin e individëve në veçanti janë të shumta, ai mund të jetë motivuar politikisht, ekonomikisht, shoqërisht, në aspektin profesional, mund të ketë tendenca kulturore, arsye shëndetësore, ndikime klimatike etj., d.t.th arsyt shpesh ndërthuren, varësisht prej qasjeve aktuale. Për të kuptuar dhe analizuar më mirë migracionin në këndin ndërkombëtarë, është e rëndësishme të njohim edhe shkaqet e tjera të migracionit. Poashtu kur kërkojmë të eksplorojmë përcaktuesit e migracionit, aspiratat janë ata që luajnë një rol të dyfish në mënyra të ndërlidhura. Së pari, aspiratat e përgjithshme të njerëzve në jetë mund të jenë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë drejtpërdrejt ose indirekt në migracionin dhe e dyta termi aspiratat e migracionit përshkruan bindjen se migracioni është i dëshirueshëm (Carling, 2014).

Shkaqet janë të shumta, por më i zëshëm është ai ekonomik, gjegjësisht vështirësitë në punësim, pagat e ulëta, standardi i paqëndrueshmë edhe i pasigurt, presionet partiake, mungesa e integritimit institucional, arsyet për një jetesë më të mirë, produktivitet më të lartë, pamundësia ekonomike për të zhvilluar biznese private. Për njerëzit që jetojnë në vendet më të varfra, migracioni mund të jetë një strategji efektive për të rritur të ardhurat e tyre dhe për të mbrojtur familjet e tyre nga varfëria (Czaika & De Haas, 2017). Si faktorë tjetër konsiderohen edhe arritjet profesionale, ku vendet migrative ofrojnë mundësi më të mëdha për përsosje profesionale, mungesa e avancimeve në vendet e lindjes, mungesa e institutivave hulumtuese, kufizimi i mundësive për të punuar në profesionin e zgjedhur etj., janë poashtu faktorë vendimtarë për migrimin e popullatës (Dokument za javna politika, kako do namaluvanje na mladinska te emigracija vo RMV, 2017 <http://progres.org.mk/files/publications/Iseluvanje%20na%20mladite.pdf>).

Pakënaqësia në shumë aspekte të jetës pra i detyron të rinjtë të marrin një rrugë, që në kushte dhe mundësi tjera, sigurt nuk do të ishin nisur. Pamundësia për të arritur dhe realizuar qëllimet të cilat ata ia kanë vënduar vetvetes si detyrim të realizohen dhe pamundësia e përmbushjes së kërkesave të tyre pra e përcakton edhe faktorin e migrimit.

Në anën tjetër dëshira për të përmirësuar mënyrën e jetesës është një nga indikatorët nxitës të migrimit. Posaçërisht të rinjtë vuajnë nga mungesa e cilësisë së jetesës, kualiteteve arsimore, ata kanë ambicie për tu ngritur në pozita më të larta, për tu marrë më shkencë, art, sport, për të bërë karrierë ose biznes dhe këto mundësi për t'i arritur në jetën e tyre ua mundëson vetëm mërgimi.

Pavarësisht arsytiveve individuale për të lëvizur, shkalla e migracionit në Maqedoninë e Veriut ka lënë një shenjë të dukshme në shumë aspekte të jetës së përditshme dhe pasojat më të rënda do të ndjehen në një të ardhme të afërt. Sipas informacioneve të Bankës Botërore, papunësia e të rinjëve në vend shkon deri në 50,8%, andaj shtysa për ikjen e të rinjëve është jashtëzakonisht e lartë psh. një mjek i ri i larguar nga vendi ynë në vitin 2017, i cek personalisht faktorët e ikjes: *“Unë nuk jam aspak i lumtur me mënyrën se si është konceptuar arsimiti ynë. Cilësia e arsimit është e ulët. Arsyeja e dytë që vendosa të largohem është mungesa e vendeve të punës dhe perspektiva. E treta është fitimi i vogël, me të cilin nuk mund të jetoja një jetë dinjitoze”* thotë Dejanoviç për Radio Deutsche Welle (Federal Ministry for economic cooperation and development: Causes for migration, last acces, 12.11.2019, <https://www.dw.com/mk/млaдитe-си-одат-од-македонија-државата-не-ги-ни-брои-19538513>).

Në epokën e globalizimit, migracioni është bërë një pjesë integrale e jetës sonë. Lëvizshmëria është në kërkesë. Qëndrimi jashtë vendit dhe rritjet ndërkombëtare po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për të mbijetuar në botën e globalizuar të punës (<https://www.bmz.de/de/themen/migration/hintergrund/ursachen/index.html>). Me këtë rast, procesi i migrimit gjithnjë e më tepër po globalizohet në rafshin ndërkombëtarë, me vet faktin edhe të liberalizimit të vizave dhe lëvizshmërinë e lirë të qytetarëve nëpër shtetet e botës.

2. ARSIMIMI, STATUSI PROFESIONAL DHE IMPAKTI I PUNËSIMEVE NË VENDET E MIGRIMIT

Migrimi i të rinjëve me arsim të lartë është një nga çështjet më alarmante në vendin tonë. Duke pasur parasysh mundësitë e vogla të punësimit që ofron ky shtet për të rinjtë e kualifikuar me diploma profesionale, turma drejt ikjes nëpër vendet me mundësi të mëdha punësimi është shndëruar në invazion për të rinjtë e vendit tonë. Mjekët, punonjësit shëndetësorë, inxhinierët, mësuesit, gjuhëtarët vërshojnë drejt shteteve të Evropës Perëndimore për të gjetur vendstrehimin e përhershëm. Meqenëse tani politikat ndërkombëtare ofrojnë edhe mundësi punësimi me “pothuajse” të gjitha diplomat e Universiteteve publike dhe private kërkesa e të rinjëve për të dalur nga “kollapsi i këtij shteti” është shtuar dukshëm pasi që tani edhe shkalla e arsimimit përcakton vetë-zgjedhjen e emigrantëve (Clemens & Pritchett, 2016). Me këtë rast edhe studentët të cilët janë në proces të studimeve janë të interesuar të migrojnë, madje duke mos prituri deri në diplomim kur ju ofrohen mundësi transferimi në Universitetet e shteteve të zhvilluara duke fituar stipendione studimi, me qëllim të ngritjes dhe përsosjes profesionale. Në anën tjetër “udhëtimet ndërkombëtare të biznesit” llogariten si “vizita” nëse zgjasin më pak se një vit ose tre muaj dhe llogariten si vizita akademike por që është treguar se japin efekte thelbësore në ngritjen ekonomike (Keller, 2015 & Tani, 2017) dhe që njëkohësisht rritin tendencat e migrimit të përhershëm kur është fjala rritjen e standardit ekonomik.

Sipas Entit Shtetëror të Statistikës, "gjysma e të rinjve në Maqedoninë e Veriut dëshirojnë të shkojnë jashtë vendit, dhe madje një e treta e tyre as nuk mendojnë të kthehen në shtëpi. Perspektiva, pasiguria politike dhe partizimi i thellë janë faktorët kryesorë që i shtojnë të rinjtë të mos e planifikojnë të ardhmen e tyre në Maqedoni, dhe madje 67% e të anketuarve nga sondazhi i realizuar ankohen për probleme financiare dhe nuk besojnë se do të gjejnë punë pas arsimimit" (Додевска, 2016). Andaj alternativa e vetme që ata shohin është perspektiva në shtetet e zhvilluara.

Duke u fokusuar në atë se cilat profesione kanë oferta më të mëdha në tregun evropian të punës, statistikën flasin se mjekët dhe punonjësit shëndetësor janë ndër më të kërkuarit. Kjo sepse, migrimi ndërkombëtar nga profesionistë të shëndetit është një fushë e interesit në rritje të politikave botërore. Mungesa e personelit mjekësor në disa vende të zhvilluara perceptohet të jetë shtytës qendror i këtij fenomeni, prandaj edhe ka pasojë kritike për vendet në zhvillim (WHO, 2016), duke përfshirë këtu edhe Maqedoninë e Veriut dhe rajonin përreth.

Situata alarmante e rrjedhjes së të rinjve dhe të arsimuarve tregohet edhe nga dokumenti qeveritar Strategjia Kombëtare e Rrjetit, Bashkëpunimi dhe Reduktimi i Daljes së Personave me Edukim dhe Profesionist 2013-2020. “Pothuajse 30% e njerëzve me arsim të lartë në Maqedoni jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, dhe gati 80% e studentëve në vitet e fundit të studimeve në fakultetet teknike mendojnë ose planifikojnë të largohen nga vendi. Numri i përgjithshëm i qytetarëve tanë që jetojnë jashtë sot është shumë i madh dhe mund të vlerësohet në mbi 447,000 njerëz, që përfaqëson pothuajse 22% të popullsisë së përgjithshme në vitin 2010, me Bankën Botërore që vlerëson se jashtë Maqedonisë jetojnë dhe punojnë më shumë sesa 29% e individëve me arsim të lartë (Dokument za javna politika, kako do namaluvanje na mladinska emigracija vo RMV, 2017 <http://progres.org.mk/files/publications/Iseluvanje%20na%20mladite.pdf>).

Pra, nga shqyrtimi i këtyre të dhënave shihet se Maqedonia e Veriut duke mos ofruar kushte të mirëfillta si në tregun e punës ashtu edhe në këndin financiar ditë e më ditë po përballet me sfidën e migrimit të rinjëve.

3. ROLI I INSTITUCIONEVE SHETËRORE PËR TË PARANDALUAR INVAZIONIN E MIGRIMIT

Arsyet për shpërnguljen e popullatës janë të shumanshme dhe të natyrave të ndryshme, por spikasin kryesisht arsyet ekonomike dhe ato sociale. Një moment të tillë zhgënjimi përjetojnë edhe qytetarët e vendit tonë, ndërsa kësaj dukurie tejmasë i ndihmoi edhe liberalizimi i vizave më vitin 2010, ku qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut filluan masovikisht të lëshojnë vendin e tyre, duke shfrytëzuar këtë mundësi për një migrim drejt vendeve të zhvilluara evropiane.

Sido që të jenë politikat qeveritare, migrimi të shpie drejt reagimeve të fuqishme të disa pjesëve të popullatës. Migrimi ndonjëherë ndodh në të njëjtën kohë me ristrukturimin ekonomik dhe ndryshimet gjithëpërfshirëse sociale. (Castles, S., Haas, H., & Miller, M., (2016).

Ky migrim i preku të gjithë grupmoshat, por ishin të rinjtë e vendit që më së shumti migruan në kërkim të prespektiva dhe mundësive të reja që ofrojnë vendet me zhvillim socio-ekonomik të lartë.

Sic thekson edhe studiuesi i migracionit Ian Goldin se: "Ndryshimet në politikat e migracionit, megjithatë, do të kenë pasojë për produktivitetin". (Goldin, I. (2018)

Të gjendur në një situatë të tillë, gati se alarmente, institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmorrën një sërë masash për të parandaluar këtë invazion të migrimit, duke tentuar që një formë apo tjetër të parandalojnë idenë e largimit të përkohshëm apo shpërnguljes së përhershme të popullatës.

Një ndër veprimet institucionale të ndërmarrë ishte hartimi i “Strategjisë Nacionale për të Rinjtë” (2016-2025) nga Agjencioni për Rini dhe Sport në mbështetje të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Kjo strategji është afatgjate dhe ofron mbështetje për të rinjtë duke u ofruar atyre:

- Pjesëmarrje rinore nëpër institucionet relevante të shtetit

- Informimin rinor
- Punë rinore lokale
- Arsimim
- Punësim dhe përkrahje para punësimit
- Kulturë
- Sport
- Shëndet
- Përmirësimin e cilësisë së jetës.

Strategjia në brendinë e saj premtion shumë për qytetarët e Maqedonisë së Veriut, pasi që deri në vitin 2025 planifikohet të bëhet integrimi i të rinjve nëpër të gjitha institucionet shtetërore me qëllim që ata mos e ndjenj veten të anashkaluar.


Hap tjetër i rëndësishëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është edhe Plani Operativ sipas të cilit do të përmirësohet kualiteti i jetës në vend. Sipas këtij plani, Qeveria do të investoj 17,9 milion euro gjatë këtij viti (shumë kjo që është për tri herë më e madhe se në vitin 2014), të cilat do të distribuohen për përkrahjen e bizneseve të reja që do ti mbanin të rinjtë në vend. Gjithashtu Republika e Maqedonisë së Veriut është vendi vetëm i cili nuk është anëtare e BE-së që ofron mbështetje për të rinjtë të cilët janë punëkërkuar aktiv të regjistruar në Agjencinë për Punësim, ku për po të njëjtit pas afatit kohor prej 4 muajsh do të ofrohet ofertë kualitative për punësim, arsimim i vazhdueshëm dhe trajnim adekuat ose punë me orar të përgjysmuar. (Standard.mk, last acces: 14.11.2019)

Sipas profesorit universitar Michele Bruni:”Nëse hyrjet në tregun e punës mbeten kryesisht të ulëta, kundrejt daljeve të gjeneratave nga tregu i punës për një kohë të gjatë, ndryshimet në pagën reale nuk mjaftojnë për të barazuar kërkesën e tregun të punës dhe fuqisë punëtore, dhe anasjelltas, nëse hyrjet në tregun e punës tejkalojnë kryesisht daljet e gjeneratave nga tregu i punës për një kohë të gjatë, ekonomitë lokale nuk mund të krijojnë vende të reja të punës të nevojshme për të mbyllur hendekun”. (Bruni, M. (2017),

Promoting a common understanding of migration trends, Publisher: International Organization for Migration, fq.36)

Institucionet shtetërore janë në përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar kushtet e jetesës brenda shtetit me qëllim që të parandalohet eksodi momental. Në suaza të kësaj përpjekje Qeveria aktuale e RMV-së ka vendosur që të bëjë edhe rritjen e pagës minimale duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në rritjen e rrogës mesatare për afro 15%. Me këto ndryshim krijohen kushte për korrigjimin e pagës minimale për 15 %, gjegjësisht prej 12.507 denarë në 14.500 denarë në neto shumë, me pagesën e pagave të dhjetorit për vitin 2019, që paraqet rritje për thujse 60 për qind në raport me pagën minimale para korrigjimit të parë në vitin 2017. Po ashtu, janë ndërmarrë edhe shumë iniciativa tjera siç janë tentativat për rritjen e pagës mesatare deri në 30,000 denarë, apo edhe rritjen e pagave prej 5% deri në 25% nëpër shumë sektorë crucial të shtetit, siç janë: arsimit, shëndetësia, administrata shtetërore dhe publike, kultura etj.

Sipas UNDESA (Population Division of the United Nations Department of Economic and Social Affairs) pas një rënie fillestare, bilanci i migrimit në çdo shtet pritet të mbetet konstant deri në vitin 2050, dhe më pas pritet një ulje progresive. (Bruni, M. (2017)



4. KONKULZION

Të gjitha trajtesat, opinionet dhe gjetjet e shprehura në këtë punim tregojnë qartazi shqetësimin aktual mbi çështjen e migracionit në vendin tonë. Nga trajtesat teorike dalin në pah faktorët që shkaktojnë migracionin, opinionet tregojnë arsyet personale që tregojnë subjektet migrative, ndërkaq gjetjet statistikore flasin për shkallën numerike të migrimit, që korrespondojnë me shifra alarmante të këtij fenomeni. Analizat e shumta flasin që nëse institucionet shtetërore nuk ndërmarrin masa për parandalimin e migracionit pasojat do të jenë evidente, ku përpos largimit të të rinjve do të përballemi edhe me mungesën e kadrove profesionale mjaft të nevojshme si dhe me plakjen e parakohshme të popullsisë.

Andaj, përpjekjet për të përmirësuar strukturën e punësimeve, hapja e perspektivave të reja për punësim dhe biznese me qëllim të uljes së pesimizmit të popullata në vend do të ndikojë që migrimi të mos shihet si e vetmja alternativë për të dalur nga kriza.

BIBLIOGRAFIA

- Додевска, А. (2016), Егзодус: Секој трет образован ја напуштил Македонија, <https://prizma.mk/egzodus-sekoj-tret-obrazovan-ja-napushtil-makedonija/>
- Castles, S., Haas, H., & Miller, M., (2016), The Age of Migration : International Population Movements in the Modern World Fifth Edition, Published by Palgrave Macmillan
- Goldin, I. (2018), Migration and the economy, Economic Realities, Social Impacts & Political Choices, Oxford Marin School, Published by Citi GPS: Global Perspectives & Solutions
- Bruni, M. (2017), Promoting a common understanding of migration trends, Publisher: International Organization for Migration
- Carling, J. (2014), The role of aspirations in migration, Published by Peace Research Institute Oslo (PRIO)
- Clemens, M & Pritchett, L. (2016) – The New Economic Case for Migration Restrictions: An Assessment, Center for Global Development, https://www.cgdev.org/sites/default/files/CGD-Working-Paper-423-Clemens-Pritchett-New-Econ-Case-Migration_0.pdf
- Czaika, M. & De Haas, H. (2017), Briefing, Determinants of Migration to the UK, Published by The Migration Observatory at the University of Oxford.
- Tani, M. (2017) – Skilled Migration Policy and the Labour Market Performance of Immigrants, p.8, IZA Institute of Labour Economics, <http://ftp.iza.org/dp11241.pdf>
- Keller, L. (2015) -From refugee to migrant? Labor mobility's protection potential, p.12, Washington DC: Migration Policy Institute, <https://www.odi.org/sites/odi.org.uk/files/resource-documents/11744.pdf>
- Lauer, R. (1998), Social problems and the quality of life
- Mark, T. (2003), Etnologjia e shqiptarëve, Tiranë
- Mark, T. (2013), Lëvizjet migruese të shqiptarëve, të mbrendshëm e në popujt më afër, Tiranë
- Dokument za javna politika, kako do namaluvanje na mladinske emigracija vo RMV, 2017 <http://progres.org.mk/files/publications/Iseluvanje%20na%20mladite.pdf>.
- Federal Ministry for economic cooperation and development: Causes for migration, last acces, 12.11.2019, <https://www.bmz.de/de/themen/migration/hintergrund/ursachen/index.html> <https://www.dw.com/mk/младите-си-одат-од-македонија-државата-не-ги-ни-брои-19538513>
- Прогрес – Институт за социјална демократија и Фондацијата „Калеви Корса“ <http://progres.org.mk/files/publications/Iseluvanje%20na%20mladite.pdf>
- Standard.mk, last acces: 14.11.2019 <https://standard.mk/zaev-investiranjeto-vo-kompanii-za-inovacii-startap-kompanii-kje-ja-namali-ekonomskata-migracija-video/>
- Strategjisa Nacionale për të Rinj” (2016-2025), Agjencioni për Rini dhe Sport në mbështetje të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP www.sobranie.mk
- Robyn Rae Irdeale (2001), The Migration of professionals: Theories and Typologies, International Migration p. 39 DOI: 10.1111/1468-2435.00169, https://www.researchgate.net/publication/227747171_The_Migration_of_Professionals_Theories_and_Typologies
- World Health Organizatin (WHO, Report 2006), <file:///C:/Users/PC/Downloads/dp6517./pdf>